REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 26740/25
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data: / Datum: 16.06.25
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 103/25 16/06/2025**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 qershor 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D  D I T E**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 03 qershor 2025;
2. Draft-Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë;
3. Raporti për legalizim për vitin 2024;
4. Propozim- vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri;
5. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 26742/25
Nr. i fq. / Br. st. -1-
Data: / Datum: 16.06.25
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 104/25, 16.06.2025**

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi** ____________ <br> **Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES:** | **Sekretarisë së Kuvendit** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.06.2025** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **16 qershor 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të bashkëngjiten lista e projekteve të realizuara, të atyre që janë në realizim e sipër dhe projekteve që pritet të fillojnë dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

2. Raporti për legalizim për vitin 2024.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të përgatitet një raport i detajuar që nga fillimi i procesit të legalizimit e deri më sot dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri (Hajzer) Beqiri.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

*Me respekt!*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB-99/25 ////.2025**

# PROCESVERBAL
# NGA MBLEDHJA E PESTË E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, PËR VITIN 2025, MBLEDHJA E MUAJIT MAJ E MBAJTUR MË: 03 QERSHOR 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:33.** Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gresa Muli, Gentiana Rama, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Ramadan Parduzi Mensur Kastrati, Mensur Kasumi, Nurie Halili, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Nasuf Aliu, Sylejman Meholli, Shkelzen Xhaferi, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Munguan:** Agim Bregaj, Melihate Basholli-Latifi dhe Spasoje Stefanoviç.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Refik Maloku, anëtar i kuvendit, duke e zëvendësuar znj. Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, i cila konstatoi se në sallë janë prezentë 32 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

*Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.*

**Refik Maloku anëtar i kuvendit-**pasi hapi mbledhjen konstatoi se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen dhe marrjen e vendimeve të plotfuqishme, deklaroi se për pikat lidhur me këmbimin e pronës komunale, ai e njoftoj kuvendit se bazuar në rregulloren e punës së kuvendit, i bie ta drejtojë mbledhjen e kuvendit në mungesë të kryesueses së kuvendit.
**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-** duke ju adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: Komuna e Vushtrrisë, përkundër faktit që ka kontrata qindra mijëra euro për hartimin dhe mbikëqyrjen e projekteve, gati secilin projekt është duke e rregulluar nga dy herë. Rasti me i ri është rrethi tek parkingu nëntokësor ku pasi u ndërtua një rrethe i gjere ,prape u ndërhy në të për ta zvogëluar. Kryetar a keni ndërmarrë masa ndaj kompanive që po i hartojnë dhe po i

mbikëqyrin këto projekte. Kryetar pate premtuar se rruga “Pandeli Sotiri” do të përfundoj deri në fund të marsit. Rruga jo që nuk ka përfunduar ende por edhe ajo pjese që është kryer pre herën e dyte është kryer në mënyrë shumë të dobët dhe me siguri do të ketë nevojë të rregullohet për herë të tretë. Fati i projekteve të kësaj qeverie po mbetet tek shprehja e treta e vërteta.
**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-**vlerësoi se kryetari të komunës i ka shkuar komplet mandati, duke u marrë me projektet e mandatit të kaluar të udhëhequr nga LDK-ja, ai nuk e ka dërguar deri në fund asnjë projekt dhe se ndoshta është duke pritur që projektet e tij ti përdor si trofe fushate, duke filluar nga parkingu nëntokësor i cili projekt është një ndër projektet më skandaloze që si kryetar i komunës e ka zhvilluar. Kjo edhe për fatin se ai projekt nuk është duke u kryer sipas afateve, dhe që i ka dërmuar bizneset në atë pjesë të sheshit duke i falimentuar ekonomikisht ato biznese. Mu për këtë projekt kryetarin duhet ta vret ndërgjegjja për keqpërdorimet me këtë projekt sepse ai projekt nuk e ka as planin e fizibilitet edhe pse disa herë LDK në kuvend e ka kërkuar atë. Më tej deklaroi se kanë bërë prerje të rrugëve pa një analizë të mirëfilltë duke shkaktuar kaos në tërë qytetin. Edhe ato hapësira të gjelbërta që kanë ekzistuar kryetari i ka shkatërruar duke e betonuar tërësisht qytetin. Prandaj kryetari aktual i komunës mundet me qenë njeri i mirë por i njëjti nuk dinë të qeverisë me komunën dhe kjo duhet pranuar.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**duke ju adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: jeni në fundin e mandatit të qeverisjes Idrizi, dhe kjo qeveri për asnjë moment nuk ka dëshmuar aftësi për qeverisje të mirë, të aftë dhe progresiste në të mirë të qytetareve të komunës së Vushtrrisë. Prandaj kryetari të komunës i kaloj mandati pa përfunduar asnjë projekt madhorë edhe pse i ka prezantuar dhe shpërfaqur para publikut me pompozitet, të gjitha këto e kanë shndërruar komunën e Vushtrrisë në një kaos të vërtetë urban në një kaos të vërtetë në komunikacion në ato të nyejve kryesore të qytetit dhe ato hidro-sanitare gjithçka duke shkatërruar, betonuar dhe duke u lënë përgjysmë. Tashmë jemi dëshmitar të shkaktimit të një gjendje të tmerrshme të pluhurit dhe baltës në qytet, që dëmton rëndë kualitetin e jetë dhe shëndetin e qytetarëve, dhe tani është bërë e pamundur që qytetarët ti marrin fëmijët e tyre për të dalë në rrugë për të lëvizur për shkak të shkatërrimit të rrugëve. Kryetari kishte premtuar që për gjashtë muaj do ta bëj zgjidhjen e problemit të ujit të pijes, kjo lere që nuk është bërë, por nuk i ka futur as 6 fshatra të reja në sistemin e ujësjellësit për katër vite me radhë janë tepër shumë për të dështuar për shtrirjen e rrjetit të ujit në ato vende ku nuk ka ujë. Është lidhur kontrata me vlerë mbi 300 mijë euro për trajtimin e qenve endacak dhe prapë gjithandej qytetit i kemi qenët endacak, dhe kjo dëshmon se qëllimi ka qenë vetëm të jepet kjo kontratë por jo të bëhet zgjidhje. Kryetari ka dështuar të bëj rregullimin e punëve mbi tokë dhe po provon të bëj diçka nëntokë. Ai parking nëntokësor aty e ka shëmtuar qytetin, sepse nëse shkon tek ajo pjesë e parkut që ka mbete vetëm me ski-lift mundesh me kaluar në shesh të qytetit ose me shkallë elektronike nëse janë planifikuar të vendosen. E keni shëmtuar qytetin me ato kioska që janë nxjerr aty, sepse tendenca për të nxjerr lokale duke e ngushtuar rrugën publike është absurd i llojit të vetë. Përpos kësaj ju do të keni problem me ndarjen e atyre lokaleve-kioskave, sepse nga partia do të bëjnë presoni për ti marrë njerëzit e partisë ato lokale. Për më tepër i me këto punime në shesh i keni falimentuar ato biznese duke i bllokuar dhe duke mos iu ofruar asnjë ndihmë nga komuna. Pastaj rruga qe njihet nga të gjithë prej stacionit të autobusëve deri tek kisha, ka qenë ndër rrugët më të mira të komunës, kryetari shkon dhe e shkatërron atë rrugë duke i prerë kapakët e pusetave dhe duke tentuar gjoja të rindërtoj diçka në të dhe kjo është e pakuptimtë. Më tej nuk ke sjellë asnjë strategji për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës për mandatin tënd katër vjeçar dhe kjo është për keqardhje dhe për çdo kritikë. Mandej nuk ka e sjellë Plani zhvillimor Komunal edhe pse ke premtuar dhe plani aktual ka skaduar, në ndërkohë lëshohen leje ndërtimore pa kurrfarë kriteri dhe ndërtimet po bëhen

vend e pa vend gjithandej qytetit. Nuk keni dhe nuk keni sjellë strategji për arsim, për shëndetësi për zhvillim ekonomik, dhe se punohet krejtësisht në mënyrë ad-hoc, duke dhënë një kontratë një tender për dikë dhe duke marrë menaxherë të kontratave nga komunat tjera. Në fund tha se kryetari i komunës duhet të iu kërkoj falje qytetarëve të komunës për dështimet e tij dhe sinqerisht ndjenë keqardhje për dështimet sepse në fund të fundit Vushtrria është qytet i të gjithë neve pa dallime politike.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**fillimisht ai i uroj mirëseardhje kryetari të komunës në seancën e kuvendit, për faktin se ai në dy apo tri seancat e fundit nuk prezanton fare në seancë duke ikur nga përgjithësia e ballafaqimit me faktet dhe me dështime e tij, por edhe me përballje me argumentet e opozitës. Tutje shtoj se gjendje në qytetin e Vushtrrisë është e mjerueshme, sepse nuk ke se kah kalon për shkak të kaosit. Komuna e Vushtrrisë ka kontratë për hartimin e projekteve, dhe ka kontratë për mbikëqyrjen e projekteve ku shpenzon me dhjeta mijëra euro. Por fatkeqësia qëndron se shumica e projekteve është duke punuar me nga dy apo tri herë siç është p.sh. rr. Në Begaj, mandej rrethi tek parku i qytetit, rr. Pandeli Sotiri, pastaj projektet tek trashëgimia kulturore e të ngjashme. Lidhur me çështjen e ujit të pijes deklaroi se në mandatin e kaluar me 1.7 milion euro është furnizuar dhe shtritë rrjetit i ujësjellësit në 75% të Komunës së Vushtrrisë, ndërsa tani anomalia qëndron se për 25% të mbetur komuna po tenton për disa herë të lidhë kontratë në vlerë prej 3.4 milion euro, ndërsa ishte propaganduar tej mase se janë marrë nga 80€ për kyqje në rrejt të ujësjellësit, por ngjashëm ka vepruar edhe qeveria aktuale lidhur me renovimin e banesave të bardha ku qytetarët janë detyruar të participojnë me 100 € ndërsa në fund i kanë kthyer ato para dhe pse ka ndodhur kjo, ndërsa aty janë ngritur disa skele gjoja se po punohet por qytetarët janë duke e parë se si po punohet në Vushtrri.

**Mek Selaci, anëtar i kuvendit-**kërkoj sqarime nga kryetari i komunës lidhur me një vizitë studimore që ka ndodhur në muajin maj nga zyrtarët e Drejtorisë së Administratës, duke e sjellë vendimin për ndarjen e shumës së mjeteve financiare në vlerë prej 2000 € për atë vizitë, listën e pjesëmarrësve në atë vizitë, sepse ka informata që ka pasur persona që nuk janë fare zyrtar të komunës, si dhe një arsyetim se cilat kanë qenë përfitimet e komunës nga kjo vizitë komuna e Vushtrrisë nga kjo vizitë.

**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-**kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, që të bëhet transparent procesi i ndarjes së subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinis dhe Sportit, duke dërguar informatë me shkrim për përfituesit OJQ-të si dhe pronarët e këtyre OJQ-ve me emër dhe mbiemër, ashtu që të bëhet transparentë ky proces dhe të kemi llogaridhënie për mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se është fakt i ditur që fushata parazgjedhore zgjatë 30 ditë, por si duke këtu në kuvendin e komunës së Vushtrrisë paska filluar kjo fushatë më herët më herë për më tepër se 100 ditë deri tek ky proces. Duke sqaruar për qytetarë e komunës ceku se nuk mund të thuhet se kryetari aktual i komunës nuk ka punuar sepse në bazë të të dhënave të fundit të GAP-it, organizatë kjo e cila ka konstatuar se prej 51 premtimeve të kryetrarit të komunës 33 sosh janë përmbushur deri në qershor të vitit 2024, dhe nëse këtë e shprehim në përqindje i bie se realizimi i premtimeve është në masën 65% dhe kur të llogaritim edhe vitin 2025 atëherë del se kryetari i ka realizuar në masën gati tërësore premtimet e tij. Prandaj duke i marrë për bazë të gjitha këto fakte atëherë duhet ditur se kur duhet kritikuar sepse kritika duhet të jetë e bazuar sepse ndryshe lëshohemi në retorik boshe dhe në propagandë.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-**tha se tashmë po shihet se kryetari i komunës i ka filluar përnjëherë të gjitha projektet, në të gjitha rrugët e komunës, por asnjë nuk e përfunduar të gjitha kanë mbetur përgjysmë. Kjo bazohet edhe me faktin se në fshatin Sfaraçak prej dhjetorit të vitit të

kaluar është prishur rruga dhe janë sjellë kockat për trotuar dhe nga atëherë deri tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Në këtë kontekst vlerësoi se me nënkalimin që është bërë aty pari jo në mënyre e duhur, janë duke u rrezikuar fëmijët që shkojnë shkollë kjo edhe për faktin se nuk rruga është e demoluar, dhe ka pengesa për kalimtarët dhe sidomos për fëmijët. Prandaj për hir të korrektësisë kërkoj nga kryetari të di se kur do të përfundoj kjo rrugë.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**duke ju referuar ndarjes së subvencioneve në fushën e kulturës deklaroi se ka pranuar disa shqetësime nga disa klube sportive për mënyrën e ndarjes së subvencioneve, ajo shprehu dëshirën që të sillen të gjitha aplikacionet prej klubeve dhe OJQ-ve, sepse janë disa prej tyre që asnjëherë nuk janë shpërfaqur se ekzistoj si OJQ dhe të njëjtat janë përfituese dhe janë përjashtuar klubet tona sportive dhe OJQ-të tona këtu në Vushtrri. Ajo potencoj se shumë shpejt partia në pushtet është mobilizuar dhe ka formuar OJQ të reja për të përfituar në baza partiake, personale dhe familjare duke iu ndarë subvencione gruas, djalit, vajzës e familjarëve tjerë. I gjithë dëmi është bërë se nuk janë subvencionuar klubet sportive dhe rinia Vushtrriase që e kanë merituar dhe që kanë korrur suksese në këto fusha. Në fund tha se sportisti Rilind Musa, prapë ka fituar dy çmime në arenën ndërkombëtare dhe ai nuk është subvencionuar dhe as që është nderur me ndonjë dekoratë për këtë vit.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, u përgjigje në deklarimet e anëtarëve të kuvendit ku ceku: se rreth rrotullimi tek parku i qytetit dhe Rr. Pandeli Sotiri, ai sqaroi se ai rreth ka qenë i planifikuar që të ndërtohet po ka qenë kërkesë e qytetarëve që ai të bëhet më i vogël, sepse ka qenë i dizajnuar që të mos lejohen automjet e rënda kamionët dhe autobusët të qarkullojnë andej, deh pasi kemi marrë edhe mendimin e profesionistëve të fushë inxhinierëve dhe arkitektëve kemi vendosur që ai rreth të jetë më i vogël. Sa i përket rrugës “Pandel Sotiri” ceku se për herë të parë po dëgjon se ajo rrugë nuk është punuar si duhet sepse e njëjta është ndërtuar me gjithë infrastrukturën e mundshme përcjellëse nëntokësore dhe kanë mbetur vetëm të hiqen shtyllat elektronik dhe të vendosen trupat ndriçues. Lidhur me planin e fizibilitetit për sheshin e qytetit njoftoj se ai plan është bërë dhe të njëjtin mund ta sjellim apo edhe anëtarja e kuvendit znj.Gashi mund të bëj kërkesë për ta marr atë plan. Lidhur me pretendimet e anëtarit të kuvendit z.Meholli, vlerësoi se është vërtet se kanë nisur shumë punë përnjëherë por edhe se kanë gjetur shumë punë të pa kryera dhe prandaj është dashur të fillohen shumë punë si p.sh. rinovimi i objektit të Arkivit të Qytetit që po duke shumë bukur, dhe sikur ky objekt të ishte i përfunduar nuk do të kishte pasur nevojë të fillohet me këto punë. Më tej rregullimi i sheshit “ të Lirisë” që është afër shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina” është duke u ndërtuar dhe i ka dhënë një pamje të bukur asaj pjese të qytetit, dhe edhe ky projekt nuk ka qenë i përfunduar në mandatin e kaluar. Mandej rruga për Dumnicë të Poshtme deri në Dumnicë të Llugës me gjatësi 10 km është përfunduar tani, rruga Akrshticë-Balincë që ka qenë një rrugë shumë e dëmtuar ajo është rindërtuar dhe është bërë shumë mirë. Të gjitha këto rrugë dhe projekte do ta transformojnë qytetin dhe është normale që gjatë punimeve të ketë edhe pluher dhe balt, por shumë shpejt këto projekte do të përfundohen dhe gjatë verës kur të vijnë bashkatdhetarët nuk do të ketë telashe në lëvizje të njerëzve dhe automjeteve. Pastaj rrugët Rexhep Musa dhe Farku Beqiri, ceku se janë rregulluar në fund të mandati, por që peshat e rënd i kanë lëkundur kapakët e pusetave, por që edhe kjo problematikë është duke u zgjidhur sepse ky projekt është duke shkuar sipas dinamikës së tij. Po ashtu është edhe rr.”Lumni Surdulli” që është kryer dhe është bërë një punë e mrekullueshme që nuk ka ndodhur më herët. Prandaj ka edhe shumë e shumë projekte që janë përfunduar dhe që janë në përfundim e sipër dhe kjo po i bie se po përfundohen në prag të fushatës zgjedhor por kjo ka ndodhur për shkak të dinamikës dhe afatit të projekteve, por kjo nuk shkakton ndonjë problem për të personalisht sepse akoma nuk e ka ndarë mendjen se a do të kandidohet sërish për kryetar të

komunës këtë gjë është duke e menduar. Lidhur me deklarimet e anëtarit të kuvendit z.Lahu se 75% e komunës ka qenë e furnizuar me ujë të pijes ceku se nëse kjo do të ishte e vërtet atëherë ai publikisht do të kërkonte falje por kjo nuk është e vërtet. Ai njoftoj se është bërë plani për studimin e fizibilitetit për ujësjellësin që do të bëhet përmes pompave dhe sistemit të mbushjes së bazenit e që mendon se do të jetë një projekt i qëndrueshëm. Lidhur me pyetjen e anëtarit të kuvendit z.Selaci për vizitën në Shkodër njoftoi se ajo është realizuar për gratë zyrtar të komunës dhe është bërë për nder të datës 8 mars. Për çështjen e ngritur nga z.Parduzi, për përfitimet e OJQ-ve, do të kërkon nga Drejtori i Kulturës që të sillet ajo listë e përfituesve që ta kemi një pasqyrë të qartë. Lidhur me ndarjen e subvencioneve në sport kulturë dhe rin ceku se ato subvencione janë ndarë përmes një komisioni që ka qenë plotësisht i pavarur dhe nuk ka interferuar asnjëherë si kryetar i komunës. Për më tepër si komunë për këtë mandat ka pasur një rritej të investimit për rinin për studentët për bursa dhe përkrahjen të sportit përmes sponsorëve. Lidhur me bllokimin e dy projekteve të trashëgimisë kulturore ai tek ura e gurit dhe tek Kalaja ceku se në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës shumë shpejt këto projekte do të zhbllokohen. Në fund duke i falënderuar të gjithë për propozimet, vërejtjet dhe kritikat vlerësoi se për të gjitha punët dhe projektet brenda këtij mandati vlerësimin dhe vulën do ta japin qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.
**Refik Maloku anëtar i kuvendit-**në cilësinë e kryesuesit të mbledhjes, njoftoj kuvendin se si materiale shtesë kanë ardhur 3 pika shtesë për futje në rendin e ditës në ç' rast fjalën ja kaloj Drejtori të Kadastrit për ti prezantuar dhe arsyetuar këto pika të rendit të ditës. Po ashtu ai sqaroi dhe kërkoi që tek pika numër 2 në renditjeje propozim –vendim për ndarjen e dekoratave të futen bashkërisht edhe dy propozime të reja për çmimin "krenaria e Sportit" dhe atë çmimi krenaria e sportit Erjon Morina post-mortum dhe Klubi i Tifozëve "Forca" Krenaria e Sportit" po ashtu. Prandaj këto dy propozim inkorporohen tek pika 2 e rendit të ditës.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-** prezantoj dhe arsyetoj para kuvendit tri pika të rendit të ditës për këmbim të pronës komunale ku dy prej tyre kanë qenë edhe në seancën e muajit prill dhe i kanë kaluar të gjitha procedurat ligjore sepse e kanë marrë edhe vlerësimin e Ministrisë së Financave, këto pika për inkorporim ne rendin e ditës janë kërkesa e Bashkësisë Islame si **propozim- vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike, pika e dytë është** *Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. "Gj.K. Skënderbeu" në Vushtrri; si dhe pika e tretë është kërkesa që ka ardhur sot për këmbim prone si propozim-vendim* **për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.**
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi që të futet në rendin e ditës propozim për rritjen e pagave të punëtorëve të Ndërmarrjes "Përparimi" duke marrë për bazë se paga e tyre është e barabartë me pagën minimale në Republikën e Kosovës si dhe duke marrë për bazë shkallen e inflacionit që është shkaktuar në vendin tonë.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**lidhur me çështjen e këmbimit të pronave ato nuk e kanë kaluar filtrin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe të njëjta janë proceduar vetëm para pak minutash edhe pse vlerësimet nga Ministria e Financave janë bërë para më tepër se dy javë ditësh. Tutje propozoi që të futet në rendin e ditës një kërkesë si propozim-vendim për ofrimin e ndihmës financiare për një rast i cili tash e disa ditë është duke kërkuar ndihmë financiare prej njerëzve të vullnetit mirë sepse kostoja e trajtimit jashtë vendit është tepër e lartë prej 52,000.00 € bëhet fjalë

për një fëmijë Leonit Reimann, nga Vushtrria, andaj kërkoj edhe nga kryetari i komunës që ta shikon dhe ta përcakton shumën e mjeteve financiare sipas mundësisë.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**propozoi që të futet në rendin e ditës një kërkesë si propozim-vendim për ofrimin e ndihmës financiare për z. Rexhep Hajredini për ndërtimi e shtëpisë së tij nga fshati Stanoc i Epërm të cilit gjatë vitit 2020 vërshimet ia kishin shkartuar shtëpinë dhe nga viti 2020 ai jeton me qira në Vushtrri, kërkoj që të apostrofuarit ti ndahet vlera financiare prej 20,000.00 €.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se propozim për ndarjen e çmimit "Krenari e Sporti" për Grupin e Tifozëve "Forca" nuk është konform rregullores sepse ky çmim ndahet për sport për individ-sportistë për arritje kulminante si dhe për sporte kolektive për klube sportive, e në rastin konkret grupi Forca nuk është klub sportiv. Në këtë kontekst ka rrezik që kjo pikë e rendit të ditës dhe ky vendim të kthehet i kundërligjshëm nga ana e MAPL-së.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**e mbështeti propozimin që të ndahet ndihmë financiare për z. Rexhep Hajredinin, të cilit i është shkartuar shtëpia nga vërshimet dhe i njëjti e ka bazën ekonomike shumë të dobët.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**lidhur me propozimin e z.Lahu për rritje të pagave për punëtoret e "Përparimit" është propozim shumë i drejt dhe humanë, dhe njoftoj se kjo çështje është diskutuar në bordin e drejtorëve dhe Komisionin e Aksionarëve të Kompanisë, por beson se ky vit fiskal është tejet sfidues për shkak të deballancimit që ka shkaktuar Kontrata Kolektive e Arsimit dhe Shëndetësisë dhe borxhet që kanë rrjedhë nga ana e saj. Prandaj vendimin për rritjen e pagave e merre bordi drejtues i Kompanisë, dhe propozoi që kjo çështje të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër të analizohet dhe të bihet një vendim i drejt dhe i ligjshëm. Lidhur me propozimet për dekorata vlerësoi se vullneti është që ato të ndahen por vetëm brenda rregullores së kuvendit.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se e mirëkupton faktin se vendimet kur merren duhet të analizohen dhe më pas të aprovohen. Ai është pro që të ndihmohen ata punëtor, por shtoj se është i mendimit që Komuna Drejtoria e Financave së bashku me Ndërmarrjen të bëjnë një analizë dhe më pas të sjellët në kuvend propozimi për rritjen e pagave për ata punëtor. Pra ai e tërheqë propozimin e tij me kusht që pas analizë të sillet propozimi.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**tha se vendimeve për ndarjen e çmimit "Krenaria e Sportit " duhet në vendim të iu përcaktohet edhe vlera apo shuma e mjeteve financiare që iu takon në bazë të rregullores.
**Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-**propozoi që tek çmimi "Krenaria e Sportit" të futet edhe ndarje e këtij çmimi për Klubin e Hendbollit vajzat U-16 që janë kampion i Republikës së Kosovës.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**lidhur me propozimet për këmbimin e pronës kërkoj që këto propozime të dalin në votim në mënyrë individuale, arsyeja është se njëri nga propozimet konkretisht ai tek rr. Gj. K. Skënderbeu ka ankesa nga ana e disa qytetarëve të cilët po pretendojnë se po mbyllet rruga, ai kërkoj që ky propozim të tërhiqet ndërsa në të kundërtën grupi kuvendar i LDK-së do të votoj kundër.
**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-**tha se propozimi për rritjen e pagave për punëtoret e N.P.L Përparimi, është mirë që kur të vjen në seancën e ardhshme të përfshihen edhe punëtoret që punojnë nëpër shkollat e komunës. Po ashtu është mirë të bëhet një analizë se si qëndron puna me pagat nga Drejtori i Kompanisë dhe i stafit administrativë dhe të analizohet se a duhet që edhe këta të futen në këtë rritje pagash. Tek këmbimi i pronave ceku se nuk e di se përse ka nevoj të bëhet këmbim pronash tek rruga "Ali Kelmendi" ku shihet se trotuari është komplet në pronësi komunale dhe se Bashkësia Islame ka mjaft prona. Tek rruga GJ.K. Skënderbeu shihet se kemi një rrugë të bllokuar, prandaj propozoi që të ngritët ndonjë komision që do ta shikonte gjendjen në teren dhe

më pas të merret një vendim i drejt dhe i ligjshëm. Kërkoj që këto pika të shtyhen për ndonjërën nga seancat e ardhshme ashtu që të analizohet mirë gjendje para se të merret vendimi për këto çështje.

**Në vazhdim kryesuesi i mbledhjes z. Refik Maloku, konstatoj se prezent janë 31 anëtar të kuvendit dhe me pas në mënyrë individuale i hodhi në votim pikat e dërguar si materiale shtesë dhe atë si në vijim:**

**Pas votimit kuvendit me vota "unanime" aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për ofrimin e përkrahjes financiare për Leonit Reimann.**

**Kuvendit Pas votimit kuvendit me vota "unanime" aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për ofrimin e përkrahjes financiare për ndërtimin e shtëpisë për z. Rexhep Hajredini.**

***Kuvendit Pas votimit kuvendit me 14 vota "për" 15 vota "kundër" nuk e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. "Gj.K. Skënderbeu" në Vushtrri.***

**Kuvendit me vota 23 vota "për" 7 vota "kundër" aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.**

**Kuvendit me vota 23 vota "për" 5 vota "abstenim" aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.**

**Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime", aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 prill 2025;
2. Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit;
3. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.209/20 për dhënien e dekoratave;
4. Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
5. Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati;
6. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetor 2026/01;

7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit Nr.14403/25 për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e proceduarve të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automarimang brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike;
9. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike;
10. Propozim-vendim për ofrimin e përkrahej financiare për shërim për z.Leonit Reimann;
11. Propozim-vendim për ofrimin e përkrahej financiare për ndërtimin e shtëpisë për z.Rexhep Hajredinaj;
12. Pyetje dhe përgjigje.

**1.** Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 prill 2025;

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**kërkoj nga sekretaria e kuvendit që në faqe 5 të procesverbalit të përmirësohet diskutimi i nënkryetares së komunës znj.Hava Mlinaku-Rruka të konstatohet se ajo në diskutimin e saj e kishte pranuar që punimet për projektet tek ura e gurit dhe Kalaja e Qytetit janë ndaluar nga ane Mesitnisë së Kulturës, dhe jo të thuhet se për këtë çështje do të merrni përgjigje dhe informata nga Drejtoria e Urbanizimit.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**kërkoj që të përmirësohet procesverbali i Komitetit për Politikë dhe Financa, ku thuhet se komitetit me shumicë votash vendosi për çmimin "Emblema e Vushtrrisë" por Komitetit për Politikë dhe Financa nuk vendos por vetëm rekomandon.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota "unanime" miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 prill 2025, me vërejtën dhe ndryshimin e cekur si më lartë.**

**2.** Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit;

Në vazhdim kuvendit diskutoj dhe i shqyrtoj veç e veç propozimet për çmimet kryesor që dalin nga Rregullorja për Dekorata.

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Emblema e Vushtrrisë".**

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**lidhur me çmimin "Emblema e Vushtrrisë" të propozuar për z. Dibran Përçukun u deklarua se kryetari i komunës ka bërë nderë të madhe kur e ka propozuar këtë figurë për këtë çmim. Profesorin Dibran e njohim të gjithë, si një aktivist i madh për çështjen kombëtare si për kontribut për fondin 3% dhe po ashtu si pjesëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai cilësoi se ky personalitet është plotësisht meritor dhe bëri thirrje të përkrahet ky propozim në mënyrë unanime.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se profesorin Dibran e njohim të gjithë dhe i njëjti e meriton këtë çmim për faktin se ka një veprimtari dhe bagazh të pasur në fushën e arsimit por edhe kontribut për çështjen kombëtare si pjesëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më tej shtoj se për këtë çmim

ka qenë i propozuar edhe Dr.Arsim Gërxhaliu si një profesionist i madh që ka dhënë një kontribut të çmuar po që ai është larguar nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-** e vlerësoi lartë kontributin e z. Dibran Përçuku si veprimtar i çështjes kombëtare dhe si ish pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ai deklaroi se Dibrani është plotësisht meritor për këtë çmim. Për sa i përket Arsim Gërxhaliut, nuk është dashur të hiqet nga ky çmim sepse ai ka dhënë një kontribut të madh në fushën e shëndetësisë dhe i dëshmuar në çështjen kombëtare.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin "Emblema e Vushtrrisë", nderohen z. Dibran Perçuku për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

**2.** Dorëzimi i çmimeve do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Hasan Prishtina".**

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**vlerësoi se të gjithë jemi koeshient për kontributin e vëllezërve Novosella, si të burgosur politikë të cilët një jetë njeri ia kanë kushtuar çështjes kombëtare. Këto personalitete janë plotësisht meritore për ti nderuar me këtë çmim, kërkoj që ky propozim të aprovohet unanimisht.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota "për" 6 vota "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, me rastin e organizimit të manifestimit "Ditët e Hasan Prishtinës", me çmimin "Hasan Prishtina", nderohen vëllezërit Sabri, Selatin dhe Bedri Novosella, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

**2.** Dorëzimi i çmimit do të bëhet nga Kryetari i Komunës, me rastin e mbajtjes së manifestimit "Ditët e Hasan Prishtinës".

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Pena e Artë".**

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se personaliteti i Mentor Hasnit e meriton këtë çmim për kontributin e tij në fushën e Historisë, i cili si profesor në Fakultetin e Filozofisë, ka marrë pjesë në simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare për çështjet që lidhen me historinë.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin "Pena e artë", nderohet Prof.asoc.Dr. Mentor Hasani, për kontributin e dhënë në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

**2.** Dorëzimi i çmimeve do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Krenari e Sportit të Vushtrrisë" Erjon Morina (post-mortum).**

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Krenari e Sportit të Vushtrrisë" Klubi i Hendbollit "Samadrexha F" U-18**.

**Propozim- vendim për ndarjen e çmimit "Krenari e Sportit të Vushtrrisë" "K.T. Forca" në Vushtrri.**

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**pyeti se për secilin vendim që merret për ndarjen e çmimit "Krenari e Sportit të Vushtrrisë" a do të bëhet pagesa vetëm për njërin apo secilin vendim/
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**deklaroi se për çmimin "krenaria e sportit" i kemi tri propozime dhe atë për Erjon Morina post-mortum, "K.T. Forca" në Vushtrri, si dhe **Klubi i Hendbollit "Samadrexha F" U-18**. Andaj vlerësoi se këto tri propozime janë të duhura dhe meritore për të iu ndarë këtë çmim. Apeloj tek anëtarë e kuvendit që ti përkrahin me votë këto propozime.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" (individuale), nderohet Erjon Morina (post mortum), për kontributin e dhënë në sport.

**2.** Dorëzimi i çmimit do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**1.** Me këtë vendim në rastin e shënimit të "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë", me çmimin "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" nderohet **Klubi i Hendbollit "Samadrexha F" U-18**, për të arriturat e tij në gara sportive nacionale, në ç' rast janë shpallur Kampion në Super Ligën e Republikë së Kosovës.

**2.** Dorëzimi i këtij çmimi bëhet në mënyrë solemne nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2025.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**1.** Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" (kolektiv), nderohet grupi "K.T. Forca" në Vushtrri, për kontributin e dhënë në përkrahjen e madhe të klubit të futbollit "FC Vushtrria".

**2.** Dorëzimi i çmimit do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**3. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.209/20 për dhënien e dekoratave;**

**Fatmir Feka, përfaqësues i Zyrës Ligjore-**paraqiti sqarime hyrëse lidhur me Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.209/20 për dhënien e dekoratave, duke elaburuar nenet e caktuara të cilat kanë pësuar ndryshime.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**fillimisht propozoi që kjo draft-rregullore të hiqet nga rendi i ditë për faktin se e njëjta nuk është përgatitur si duhet ka shumë mangësi, kjo bazohet edhe e atë se në Komitet për Politikë e Financa ka ardhur një tjetër dokument ndërsa në kuvend tjetër. Ajo ceku se në plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje është përmendur çmim "Nderi i Qytetit", "Qytetar Nderi" dhe "Emblema e Vushtrrisë" e ka dhënë kryetari i komunës dhe kjo fare nuk ka pasur nevojë të ceket sepse e njëjta ekziston edhe në rregulloren e vjetër. Kërkoj që për këtë rregullore të zgjerohet komision hartues edhe me anëtarë të kuvendit dhe kësisoj të bëhet një rregullore e mirë.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**pyeti hartuesi e këtij drafti lidhur me nenin 5 paragrafi 4.1 ku thuhet se "çmimi krenari e sportit" mbetet në diskrencionin e kryetarit të komunës për ndarjen e tij, në çka janë bazuar kur kanë shtuar këtë nenë.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se në bazë të legjislacioni në fuqi është e përcaktuar proceduar e plotësim ndryshimit të një rregulloreje dhe hartimit të një rregulloreje të re atëherë kur preken shumë nene dhe paragrafë të asaj rregulloreje. Ai përkrah propozimin që ky dokument të shtyhet për ndonjë nga seancat e ardhshme dhe të punohet një rregullore më e kompletuar. Po ashtu ceku se është dashur të bashkëngjitet këtij draft edhe rregullorja e vjetër, sepse kemi p.sh kontrabandim të disa neneve siç është çmim "Latif Berisha" dhe qitet mbi çmimin "Nxënës i dalluar" dhe ne nuk e dimë qëllimin e krijohet konfuzitet për kuvendarët. Ai nuk pajohet po ashtu me frymën e kësaj rregulloreje sepse, nuk mundet që kompetencat e kuvendit për ndarjen e dekoratave kryesore të lihen në diskrecion të kryetarit të komunës. Kryetari i komunës është duke u sillë shumë rreth emrit të Latif Berishës dhe kjo është për tu respektuar, por ai kujtoj se ai dhe subjekti i tij politikë e dinë se si e kanë nderur dikur Latif Berishën, ku brenda ditës është hequr emri Shkollës së Mesme Teknike dhe është emëruar një shkollë fillore në një fshatë në një lokacion shumë më periferik, por kjo ndoshta është për ti larë mëkatet nga e kaluara. Krejt kjo ngjarje e nderimit të emrit ishte festar me armë dhe fishke-zjarre.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**u ndal tek me nenin 5 paragrafi 4.1 ku thuhet se "çmimi krenari e sportit" mbetet në diskrencionin e kryetarit të komunës për ndarjen e tij, në çka janë bazuar kur kanë shtuar këtë nenë. Po e vërteta është se ky nenë bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku janë pacaktuar saktë kompetencat mes kryetarit të komunë dhe kuvendit dhe kjo e drejt i takon kuvendit.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**njoftoi se nuk ka marrë pjesë në hartimin e kësaj rregulloreje, dhe se komisioni ka qenë plotësisht i pavarur në punën e tij, dhe për këtë ai nuk ka kurrfarë kompleksi. Tutje shtoj se tek diskrecioni i kryetari të komunës, nuk bëhet fjalë për ndarje të çmimeve, por vetëm në shpërndarjen solemne të atyre çmimeve ndërsa kryetari nuk interferon në vendimmarrje. Pastaj ai duke replikuar ceku se ai mund edhe të ketë dobësi, po nuk vuan nga kompleksi i gllabërimit të pushtetit. Mandej shtoj se nuk kishte pasur kurrë dëshirë që të dëgjoj një debati të tillë prej një intelektual duke ju adresuar z.Meholli, duke vlerësuar se ai nuk identifikohet me atë që shtijë me armë, dhe se ai nuk e ka pozitën çka do dhe tek e fundit e lëshon krejt këtë pozitë sepse njerëzorja është për të mbi të gjitha. Ai ju adresuar z.Meholli se ai deri dej ka qenë në parinë politike AAK, dhe tani në LVV, por kjo nuk duhet të merret dhe të vlerësohet se gjithçka është vetëm me partinë. Ai vlerësoi se nuk parqet fare problem për të që kjo rregullore të shtyhet dhe të bëhet një komisioni më i zgjeruar për ta bërë një rregullore për së mbari. Ajo çka i luti anëtarë e kuvendit është që të shikohet një propozim për shoqëri kulturore-artistike që ka vepruar në periudhën 1996-1998 që një çmim të futet në këtë rregullore që edhe kjo shoqëri të nderohet për veprimtarinë që e ka pasur.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se kjo draft-rregullore është tepër e mangët, dhe ceku se e njëjta ka shumë gabime teknik dhe përmbajtjesore. Ajo çka është tepër e pa kuptimtë është neni 9 i saj ku thuhet: kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, dhe kjo i bie se i kemi dy rregullore.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi që këtë çështje ta kthej sërish në komisioni për trajtim dhe ripërpunim dhe të njëjtën ta sjellë në kuvend për aprovim.**

**4.** Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se me ndryshimet e fundit në legjislacionin në fuqi është përcaktuar që komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në të bëhet ad-hoc vetëm për një konkurs dhe jo siç ka qenë më herët për të gjitha konkurset. Tutej ai vlerësoi shumë lartë mësimdhënësin Ferit Avdiu dhe ceku se është adekuat për tu emëruar në këtë komision, për faktin se ka një përvojë të gjatë në fushën e arsimit dhe ka shërbyer gjatë edhe si drejtor shkolle.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**shtroj pyetje se e propozuar për anëtare të komisionit znj. Sadete Gërguri, zyrtare e DKA-së, për të cilën nuk kemi njohur se kush është, sepse është zyrtare e re, por dilema është se a i njeh ajo personelin arsimor të cilën do ta përzgjedhë për udhëheqje të shkollave.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se këtij propozim-vendimi është dashur ti bashkëngjitet edhe një biografi e shkurtër të peronave-zyrtarëve që do të zgjidhen në këtë komision i cili është mjaft i rëndësishëm për nga detyra e tij sepse do të merret me zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave. Pastaj shtoj se fryma e ligjit dhe udhëzimit administrativ është tejet progresiste sepse ka përcaktuar që ky komision të vendoset nga ana e kuvendit dhe i ka lënë një kompetencë në dorë komisionit që të bëj përzgjedhjen e pavarur për drejtor dhe zëvendës-drejtor të shkollave. Kjo është demokratike dhe shërben në depolitizimin e arsimit në rrafshin komunal të organizmit.
**Hashim Hajrizi, zyrtar në DKA-**paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke cekur se ky komision ka mandat ad-hoc që lidhet vetëm me konkursin që tashmë është shpallur.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 26 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

**1.1.** Sadete Gërguri, zyrtare e DKA-së;

**1.2.** Ferit Avdiu, drejtor i SHFMU "7 Marsi", Bukosh;

**1.3.____________________**, përfaqësues i MASHT-it.

**2.** Komisioni do t'i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Rregullores (QRK) Nr.19/2024, për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zv. drejtorëve, mësimdhënësve bashkëpunëtorëve profesional, asistenteve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo –arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar.

**3.** Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat ad hoc.

**4.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartcekur.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati;

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-** deklaroi se e përkrahë kërkesën e znj. Ajmane Ferati, e cila nuk ka mirë gjendjen shëndetësore, duke shtuar dhe kërkuar nga anëtarë e kuvendit që votojnë për aprovimin e kësaj kërkese që ti dilet në ndihmë sado pak zonjës në fjalë. Po ashtu ai ceku se kësaj zonje i kemi hyrë në hak duke mos ja dhen meritën e duhur sepse kjo gjatë luftës ishte e angazhuar në qepjen e uniformave për pjesëtarët e Brigadës 141 "Mehë Uka" të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe nga ky fakt kjo zonjë është dashur të shpallet veterane e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet kërkesën në fjalë për ofrimin e ndihmës financiare për znj. Ajmane Ferati.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**sqaroi se ky vendim do të realizohet nga kategoria subvencione dhe transfere në zyrën e kryetarit të komunës, ose ku ka mjete të lira buxhetore.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim znj. Ajmane Ferati-Shatrolli, nga Vushtrria, i ndahen mjete financiare në shumë prej tremijë euro (3,000.00 €), ndihmë financiare për shërim.

**2.** Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 730, kodi i nënprogramit 73033 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6.** Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetor 2026/01;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime lidhur me Qarkoren Buxhetor 2026/01, me të cilën janë përcaktuar kufijtë buxhetor për buxhetin e komunës për vitin 2026, ai sqaroj me shifra konkrete vlera dhe shumat financiare për kategoritë ekonomike të buxhetit të komunës dhe fazat e planifikimit të tij.

**7.** Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit Nr.14403/25 për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e proceduarve të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automarimang brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 14403 datë 27.03.2025 për formim të Komisionit Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automerimangë brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që çështjen e dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me auto merimangë në Komunën e Vushtrrisë të e procedoj/ rregulloj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoritë tjera kompetente.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bashkësisë Islame në Vushtrri.

**2.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-02253-10**, në sipërfaqe prej **59.35m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **2492m$^2$** ZK Vushtrri, pronë e Bashkësia Islame në Vushtrri me përfaqësues Ejup Haziri , me pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-02253-24**, në sipërfaqe prej **21.41 m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **19388m$^2$** ZK Vushtrri, pjesë nga parcela **P-70202016-02253-3**, në sipërfaqe prej **37.94m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **8259m$^2$**, pronë e Komunës Vushtrri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

**3.** Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

**4.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**9.** Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 25 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company SH.P.K me përfaqësues Naser Imeri.

**2.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-6570-0** në sipërfaqe prej **161m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **5267m$^2$** ZK Vushtrri pronë e Ariani Company SH.P.K, me pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-1106-1-0**, në sipërfaqe prej **161 m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **3707m$^2$** ZK Vushtrri, pronë e Komunës Vushtrri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës- kyqje në rrugën publike në Rr. "Gjon Buzuku", bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

**3.** Këto prona iu janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

**4.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**10.** Propozim-vendim për ofrimin e përkrahej financiare për shërim për z. Leonit Reimann;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**në cilësinë e propozuesit të kësaj pike të rendit të ditës sqaroj se bëhet fjalë për një fëmijë të vetëm në familje Leonit Syla[1] nga Duminica e Poshtme e

---

[1] *Sqarim anëtari i kuvendit z. Sylejman Meholli gjatë prezantimit të propozimit të tij, përfituesit të ndihmës i referohet me mbiemrin Syla, por nga shikimi i dokumentacionit vërejmë se mbiemri i vërtetë i këtij përfituesit të ndihmës është Reimann.*

Vushtrrisë, të cilit për shërimin e tij i janë grumbulluar 52,500.000 €, ndërsa i nevojiten edhe 12,500.00 € për trajtimin e sëmundjes së tij jashtë vendit. Kërkoj nga kuvendi që aprovoj këtë kërkesë për ofrimin e ndihmës financiare.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**tha se kur po bëhet fjalë për ndihma financiare dhe vendime që po aprovohen në mënyrë ad-hoc, bëri të ditur se po kemi shumë raste kur këto vendime po kthehen si kundërligjore nga ministria e linjës për shkak të mos respektimit të rregullores së brendshme. Po ashtu është vërejtje e auditorit të jashtëm, që parqet shkelje mos kalimi i këtyre kërkesave në komisioni profesional shëndetësor për trajtim, dhe që drejtori duhet ta ketë një raport specialistik mjekësor, dëshmi apo raport mbi shpenzimin e shumës përfituese
**Ferit Idrizi. Kryetar i komunës-**deklaroi se me që kemi të bëjmë me një rast dhe sëmundje të rënd të këtij fëmije, propozoi që Leonit Reimann të ndahet shuma 5000 € për shërim.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim z. Leonit Reimann, nga Vushtrria i ndahen mjete financiare në shumë prej pesëmijë euro (5,000.00 €), ndihmë financiare për shërim, mjetet financiare do të derdhen në gjirollogarinë bankare të prindit të tij z.Ilaz Reimann.

**2.** Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 730, kodi i nënprogramit 73033 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**11.** Propozim-vendim për ofrimin e përkrahej financiare për ndërtimin e shtëpisë për z.Rexhep Hajredinaj;

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**sqaroi se propozim i saj është për ofrimin e ndihmës financiare në vlerë prej 20,000.00 € për z.Rexhep Hajrdinin nga fshati Stanoc i Epërm, ndihmë për ndërtimin e shtëpisë së tij, e cila ishte shkatërruar gjatë vërshimeve të vitit 2020, dhe prej atëherë i njëjti jeton me qira në Vushtrri. Kërkoj që kjo kërkesë të dal në votim për aprovim nga anëtarë e kuvendit.
**Ferit Idrizi. Kryetar i komunës-**tha se aktualisht gjendja financiare e komunës është tepër e vështirësuar për faktin se këto mjetet që u propozuan merren nga kategoria subvencione dhe transfere dhe edhe kjo kategori është prekur nga procedurat përmbarimore për kontratën kolektive të arsimit dhe shëndetësisë. Më tej sqaroi se realizimi i këtij vendimi do të jetë tepër i vështirë në mungesë të mjeteve financiare, por në këtë stad edhe sikur të kishte mjete do të jetë i vështirë alokimi i mjeteve në kategorinë subvencione dhe transfere. Andaj në fund ai tha se ky vendim të lihet në duar e anëtarëve të kuvendit ashtu siç e kanë vullnetin por që realizimi i tij do të jetë tejet i vështirë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-** vlerësoi se do të ishte mirë që disa nga kompanitë lokale ndërtimore, që qëndrojnë mirë financiarisht të kontribuojnë në ndërtimin e shtëpisë për z.Rexhep Hajrdinaj, dhe komuna në këtë rast do të ishte mirë të përdor autoritetin e saj për ta lehtësuar këtë proces.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**përsëriti se me këto vendime në këtë formë është duke u shkelur rregullorja komunale për ndarjen e subvencioneve. Tuje shtoj se në këtë gjendje që jemi aktualisht nuk fare mjete për realizimin e këtij vendim sepse jemi në borxhe për shkak të procedurave përmbarimore.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se ketë propozim e përkrah plotësisht dhe kërkoj nga kryesuesi i mbledhjes që ky propozim të dal në votim për aprovim.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim z. Rexhep Hajredini, nga fshati Stanoc i Epërm i ndahen mjete financiare në shumë prej njëzetmijë euro (20,000.00 €), ndihmë financiare për ndërtimin e shtëpisë.

**2.** Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kategoria subvencione dhe transfere..

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës, si dhe drejtorë tjera ku ka mjete të lira buxhetore nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të bëhet realizimi i këtij vendimi.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora 15:00**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Refik Maloku** |
| ____________ | ____________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese i Mbledhjes** |

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KOMUNA VUSHTRRI**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 13.06.2025 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin Komunal |
| **PËRMES;** | Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës |
| **NGA/OD/FROM;** | Abit Abiti, ZKF |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 |

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2026/01, e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe po e dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument është dokumenti bazë për planifikimin e buxhetit Komunal, përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 është në përputhje me udhëzimet e dhëna me Qarkoren Buxhetore 2026/01 të nxjerra nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

Shtojcë :

- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

## 2026 - 2028

## KOMUNA E VUSHTRRISË

KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

**Përmbajtja**

I. Hyrje
II. Deklarata e prioriteteve afatmesme
III. Vizioni i komunës
IV. Misioni i komunës
V. Korniza fiskale komunale
VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2026-2028
VII. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
VIII. Analiza gjinore
IX. Informacionet sipas programeve

# I. Hyrje

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2026. Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte: - Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël, - Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës, - Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe - Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë.

Fazat e përmbledhura të KAB-it Komunal dhe afatet kohore




**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

## II. Deklarata e prioriteteve afatmesme

Bazuar në nevojat momentale të popullatës, resurset në dispozicion dhe përvoja, Komuna e Vushtrrisë është e pozicionuar për të gjeneruar një strategji të re zhvillimore që synon në përsosjen e strukturës së saj ekonomike, rritjen e punësimit, dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e përgjithshëm të zhvillimit lokal, prodhimtarisë, bujqësi moderne dhe turizëm. Kjo strategji e re e zhvillimit ekonomik siguron një vizion për Komunën e cila përfshinë synimet specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ato të mesme (NVM) dhe të bujqësisë, si dhe programet dhe projektet për ti realizuar këto synime. Komuna e Vushtrrisë ka një shtrirje të bizneseve shumë të sukseshme dhe aktive në tregun e Kosovës dhe tregun e jashtëm që e ushtrojnë aktivitetin afarist. Në të vërtetë, Komuna e Vushtrrisë tanimë është duke punuar për të përsosur ambientin për biznes duke punuar në finalizimin e Zonave Ekonomike si zona komerciale, artizanale dhe prodhuese, duke përfshirë këtu bizneset e mëdha dhe të vogla, ndërmarrësit dhe organizatat aktive në Komunë kanë bërë një ndryshim në mendimin rreth zhvillimit ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në këtë qasje të zhvillimit komunal. Këto synimet kërkojnë një riorganizim të konsiderueshëm, ndryshim në proceset e punës në institucionet e qeverisjes lokale, krijimin e mekanizmave të rinj për bashkëpunim ndermes sektorit publik dhe privat, dhe formimi dhe ndërtimi i kapacitetit të institucioneve dhe organizatave të reja që do të marrin përgjegjësinë për zhvillim ekonomik. Për të përmbushur këto synime ambicioze, Komuna e Vushtrrisë duhet të mobilizojë dhe angazhoj të gjitha resurset që janë në dispozicion, të cilat resurse qartazi do të jenë të pamjaftueshme për implementimin e tërë planit. Si rrjedhim, Komuna do të kërkoj përkrahje domethënëse nga nivelet tjera të qeverisjes në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në formë të diturisë, përvojës, dhe ndihmës teknike dhe financiare për të transformuar vizionet dhe synimet e saja në realitet brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme.

### PRIORITETET E QEVERISË PËR PERIUDHËN BUXHETORE 2026-2028

Prioritetet e mëposhtme për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028 janë paraqitur në mënyrë specifike të strukturuara sipas shtyllave të Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim, dhe sipas sektorëve të politikave po ashtu të definuara në kornizën strategjike. Prioritetet dhe drejtimet kryesore për zbatimin e tyre janë hartuar duke u bazuar në propozimet e ministrive të linjës që rrjedhin nga SKZH dhe strategjitë tjera sektoriale.

Duke u bazuar në këtë, organizatat buxhetore gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2026 me parashikimet për periudhën afatmesme (2027-2028), pritet të tregojnë se si plani i tyre buxhetor i përgjigjet prioriteteve të qeverisë të paraqitura më poshtë. Kundrejt prioriteteve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.

- ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK
- ZHVILLIM I BARABARTË NJERËZOR
- SIGURIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

**Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë**

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:
X1 : 200 50' 09'' dhe X2 : 210 07' 05'';
Y1 : 420 42' 20'' dhe Y2 : 420 55' 12''.
Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me supërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km2. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69870 banorë të organizuar në 11866 ekonomi familjare.

**Gjendja aktuale në ekonomi**

Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 4 172. Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në rritjen e industrisë përpunuese- prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon industrisë përpunuese- prodhuese, pastaj bizneset shërbyese, tregtia e kështu me radhë (Shih tabelën më poshtë). Këto subjekte ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Bazuar në të dhënat e Zyrës për regjistrim të bizneseve në komunë të cilat janë marrë në ARBK, nga bizneset të cilat operojnë në Komunën e Vushtrrisë, një pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 20% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 5.66% , industri përpunuese 21% etj. Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje e lehtë në përqindjen e industrisë përpunuese.
Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK

| | Vushtrri |
|---|---|
| A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI | 156 |
| B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE) | 2 |
| E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE | 14 |
| F - NDËRTIMTARIA | 274 |
| H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI | 151 |
| I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR | 233 |
| J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI | 94 |
| K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT | 20 |
| L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË | 17 |

| | |
|---|---|
| M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE | 205 |
| N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE | 189 |
| O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM | 8 |
| P - ARSIMI | 75 |
| Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE | 120 |
| R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI | 59 |
| S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE | 849 |
| G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE | 820 |
| D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR | 8 |
| C - INDUSTRIA PËRPUNUESE | 878 |
| **Grand Total** | **4,172** |

**Burimet natyrore**

Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i maleve të Çyqavicës është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastudiuara sa duhet. Komuna e Vushtrrisë, përveç të tjerash, është e krahasuar edhe me shumë vende me potenciale të mineraleve dhe mundësive për eksploatime druri dhe guri, si:

- Duboc - magnezit e porcelan;
- Bivolak, Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllavatin - thëngjill druri
- Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë - eksploatimi i gurit
- Gumnishtë dhe Boshlan - pasuri të plumbit dhe zinkut
- Bajnskë - ujë termo-mineral
- Gjelbishtë dhe Gojbulë - ujë mineral
- Karaçë - burime minerale

## III.Vizioni i komunës

Komuna e Vushtrrisë është mjedis i përshtatshëm për ndërmarrësi dhe ka ndërtuar strukturë funksionale ndërlidhëse ndërmjet sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, edukimit dhe ndërmarrësisë. Vushtrria apo "Vicianum" është "shtëpi" e bizneseve dhe është identifikim I qendrës së dikurshme historike dhe tregtare.

**VI.**

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

## VII.

## VIII. Misioni i Komunës

Si zonë e veçantë historike do të marrë identitetin e saj të dikurshëm si qendër për bizneset prodhuese dhe aktivitetet tjera të biznesit duke rritë mirëqenien ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët e saj. Zhvillimi ekonomik lokal do të arrihet si bashkëveprim i zhvillimit të ambientit biznesor, prodhimtarisë dhe kulturave bujqësore, me sistem arsimor të harmonizuar me ekonominë lokale duke siguruar standard të mirëqenë jetësor dhe social. Administrata komunale do të jetë në shërbim.të plotë të qytetarëve dhe bashkëpunëtor I akterëve të ekonomisë lokale.

Bazuar në dokumentet strategjike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026-2028 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tri vitet e ardhshme. Synimi i Komunës së Vushtrrisë është që të jetë qendër e zhvillimit të qëndrushëm ekonomik me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit, jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

***SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE***

Si rezultat i hulumtimit dhe analizimit të saj, Komuna ka identifikuar aftësitë për të krijuar ndërmarrjet si një forcë që mund të jetë çelës për të krijuar ndërmarrje të reja, zhvilloj ato ekzistuese, dhe të inkurajoj krijimin e vendeve të punës. Gjatë zhvillimit të aftësive për të krijuar ndërmarrjet, Vushtrria duhet gradualisht ta ringjallë administratën komunale në shërbim të bizneseve, e cila do të kontribuojnë për një kualitet më të mirë të jetës për qytetarët e saj. Komuna do të përpiqet të zhvilloj sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe të kulturës me qëllim që të transformojë Komunën e Vushtrrisë në një qendër dinamike të ndërmarrjeve. Gjatë procesit të punëtorisë (intervistave), janë anë shqyrtuar ide të programeve për arritjen e këtyre synimeve strategjike. Idetë e propozuara ishin vlerësuar si dhe janë prezantuar këto konkluzione. Vazhdimi i procesit kërkon analizim më të thellë për të siguruar se projekt propozime kualitative do të rezantohen te akterët lokal dhe tek komuniteti i donatorëve. Objektivat për secilin synim strategjik gjithashtu janë prezantuar. Këto qëllime janë konturuar nga nën-grupet dhe pastaj janë vlerësuar. Si rezultat, Komuna ishte në gjendje të identifikojë tri projektet me prioritet të lartë për secilën synim të saj.

SYNIMI STRATEGJIK 1- Klimë biznesore të përshtatshme për biznese ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të jashtme në me fokus në prodhim

1. Përkrahja e prodhuesve
2. Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit
3. Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës
4. Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve

SYNIMI STRATEGJIK 2- Bujqësi moderne me produkte kualitative industriale dhe të konsumit direkt për tregun lokal,

1. Krijimi i Oazave Bujqësore (koperativave bashkëkohore)
2. Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore
3. Mundësimi i aplikimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore

4. Siguroje përgatitje profesionale dhe stimulim të bujqësisë

SYNIMI STRATEGJIK 3 - Ngritja e kualitetit të jetës kulturore dhe zhvillimit të turizmit

1. Vushtrria qendër historike
2. Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv

**Aktivizimi i zonës aktuale**

Komuna e Vushtrrisë është në ndërtim e sipër të zonës industriale me sipërfaqë rreth 14 ha. Përderisa kjo zonë është në proces Komuna e Vushtrrisë, specifikisht Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe bujqësi mund të filloj me ndërtimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e zonës dhe tërheqjen e investitorëve. Duke u bazuar në studimin e fizibiletit të zonës, filimisht mund të targetohen bizneset që do të alokohen në zonë. Është shumë e rëndësishme që bizneset ekzistuese të konsultohen fillimisht për nevojat dhe kapacitetet e tyre për vendosjen në zone industriale duke pas parasysh që ato janë bartëse të nivelit të deritashëm i zhvillimit ekonomik lokal.

**Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.

**Përmirësimi i ambientit të komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi), transporti dhe kanalizimi;
- Përmirësimi i standardeve ambientale;
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara.

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

**Qeveri komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes fushave prioritare të komunës dhe objektivat e saj për

periudhën afatmesme 2026-2028 do të shoqërohen me shuma të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike, të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

## Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit 2026 - 2028

Procesi buxhetor për vitet 2026-2028 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikat buxhetore të qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Gjatë hartimit të këtij dokumenti duhet t'i japim prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet strategjike.
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake;
- Të përfshijmë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të projekteve me bashkëfinancim të jashtëm;
- Të kujdesemi që të hyjmë në obligim për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza buxhetore;

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nënprogrameve në përputhje me sturukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027 – 2028;

Planifikimi i projekteve në pajtim me UA MF NR.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe shpenzimet e shpronësimit. Organizatat buxhetore, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.

Planifikimi i projekteve në pajtim me Udhëzim Administrativ Mf- Nr. 06/2019 Për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projekteve Kapitale. Kriteret e përzgjedhjes sipas këtijë UA janë:

1.1.Përputhja me Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 si dhe me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

### Parimet themelore

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve (kufijve buxhetorë) për periudhën 2026-2028, është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të mjedisit brenda të cilit zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, nxitje të punësimit të qëndrueshëm si dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. E gjithë kjo do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Përputhje me politikat prioritare të Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2023-2026, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2026.

- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;

- Rritje të cilësisë dhe besueshmërisë në procesin buxhetor si dhe ndërlidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxhetit.

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

- Ekzekutim më të lartë të shpenzimeve në krahasim me planifikimin e tyre, me theks të veçantë në shpenzimet kapitale, duke realizuar synimet specifike prioritare.

- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm të ofruar nëpërmjet IPA dhe kanaleve të tjera.

## V.Korniza fiskale

**Parashikimi i të hyrave**

Bazuar në projeksionet makroekonomike, të hyrat priten të vazhdojnë të rriten edhe në periudhën afatmesme (2026-28) me një normë mesatare prej 6.0%. Si pjesëmarrje në BPV, të hyrat priten ta mbajnë nivelin e njëjtë me vitin 2026 prej 29.5%.

Sa i përket strukturës së të hyrave, tatimet indirekte pritet të përfaqësojnë më shumë se dy të tretat e të hyrave totale në periudhën afatmesme, për t'u ndjekur nga të hyrat nga tatimet direkte me një pjesëmarrje prej rreth 17.8%; dhe të hyrat jo-tatimore me pjesëmarrje rreth 9.8% të të hyrave totale (Grafiku 7).

Tatime direkte pritet të rriten në periudhën afatmesme me një normë mesatare prej 6.5%. Kjo rritje pritet të reflektohet në rritjen e tatimit në të ardhura të korporatave dhe në tatimin në të ardhura personale me një normë mesatare prej 6.3% dhe 7.2%, respektivisht. Tatimi në pronë pritet të shënojë rritje me rreth 4.1% në periudhën afatmesme.

Të hyrat nga tatimet indirekte pritet të vazhdojnë të rriten edhe në periudhën afatmesme me një normë mesatare prej 6.0%. TVSH-ja, që ka pjesëmarrjen më të lartë në të hyrat indirekte, pritet të rritet mesatarisht me 6.6% në periudhën afatmesme, kryesisht për shkak të rritjes së importit të mallrave dhe konsumit të përgjithshëm. Të hyrat nga akciza parashihen të kenë rritje mesatare prej 4.3% në periudhën afatmesme, ndërsa të hyrat nga detyrimi doganor priten të rriten mesatarisht me 6.8%.

Të hyrat jo-tatimore parashihet të kenë një rritje mesatare prej 5.8% në periudhën afatmesme. Përderisa të hyrat jo-tatimore të nivelit qendror pritet të rriten mesatarisht 5.2%, ato të nivelit lokal pritet të rriten për 11.5%.

## Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2026-2028

Në periudhën afatmesme shpenzimet buxhetore pritet të kenë një rritje më të ulët se ajo e viteve paraprake. Gjatë periudhës afatmesme 2026-2028, shpenzimet janë planifikuar të rriten mesatarisht me rreth 5.0%.

Gjatë periudhës afatmesme, shpenzimet rrjedhëse pritet të kenë një rritje mesatare prej 5.5%. Gjatë viteve 2026-2028, kategoria e shpenzimeve rrjedhëse për paga dhe shtesa planifikohet të ketë një rritje mesatare prej rreth 6.1%. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë një rritje prej 2.4% ndërsa subvencionet dhe transferet pritet të rriten mesatarisht me rreth 6.8%. Investimet kapitale përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 25.7% të shpenzimeve totale.

| Përshkrimi | 2024 | 2026 | 2027 | 2028 (vlerësim) |
|---|---|---|---|---|
| **Indikatorët makroekonomik në Kosovë** | | | | |
| Rritja reale e BPV në % | 4.3 | 4.2 | 4.2 | 4.1 |
| Inflacioni në % | 2.4 | 2.2 | 2.0 | 2.0 |
| BPV për kokë banori, në euro | 10,253 | 10,901 | 11,653 | 12,255 |
| **Indikatorët ekonomik komunal** | | | | |
| Popullsia e komunës | 74,115 | 74,352 | 74,589 | 74,752 |
| Numri i bizneseve të regjistruara | 4,172 | 4,284 | 4,890 | 5,283 |
| Numri i nxënësve | 12,796 | 12,000 | 11,900 | 11,850 |

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

## Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 do të jetë në shumë prej 345 milion euro. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,544.3 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 do të jetë në shumë prej 338.53 milion euro.

| Përshkrimi | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 |
|---|---|---|---|---|
| A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë | 3,227.19 | 3,544.30 | 3,812.40 | 4,094.30 |
| Mbeshtetja buxhetore dhe grante | -22.5 | -22.5 | -22.5 | -22.5 |
| Tatimi në pronë | -45.0 | -50.0 | -55.0 | -55.5 |
| Grantet e percaktuara të donatorëve | -70.00 | -73.00 | -77.2 | -77.2 |
| Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale | -70.0 | -73.5 | -77.2 | -77.2 |
| Të hyrat nga interesi | -2.8 | -13.0 | -12.7 | -2.7 |
| B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna | 3,074.89 | 3,385.26 | 3,645.06 | 3,936.46 |
| C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%) | 307.49 | 338.53 | 364.51 | 393.65 |

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Sipas këtyre kritereve, Komunës së Vushtrrisë i takon:

Shumë fikse prej 140,000 €, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori.------------ 78,472.00 €

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

Numri i popullsisë (89%) ---------------------------------------------------------------- 11,437,619.00€
Shuma për madhësi gjeografike (6%) ------------------------------------------- 635,069.00 €
Shuma për popullsi pakicë në komunë (3%) ----------------------------------------- 59,466.00€
**12,210,626.00€**

***Granti specifik për Arsim parauniversitar***

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028.
Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2026 është aprovuar në shumë prej 270.46 milion euro si vijon:
- Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 16.75 milion euro,
- Shpenzime kapitale në shumë prej 2.1 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:
a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2024/2025;
b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
m) Koordinatorët e cilësisë;
n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
q) Praktika profesionale;
r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
t) Specialist të IT-së.
u) Pagesa e shpenzimeve për shujtën ditore për nxënësit nga klasat 0-5.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 4,180 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.
Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e arsimit para-universitar.

Politikat e reja të aprovuara janë si në vijim:

a) Transporti i nxënësve nga klasa 0-9, me kosto prej 3,48 milion euro,

b) Numri i personelit ndihmës për çerdhet e reja, rritje të stafit prej 138 dhe kosto për paga dhe shtesa prej 0.9 milion euro.

Bazuar në kriteret e shënuara më lartë, Komunës së Vushtrrisë i takon grant për Arsimin parauniversitar në shumë prej 10,761,610.00 € , kjo shumë nuk i mjafton për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e arsimit, por arsimi ndihmohet nga granti i përgjithshëm.

Edhe pse është investuar në masë të konsiderueshme në objekte shkollore edhe më tej gjendja në nuk është e nivelit që kërkohet, prandaj kërkohen investime. Projektet të cilat planifikohen te zhvillohen për periudhën 2026-2028 janë të paraqitura në tabelën më poshtë.

| Arsimi | | | |
|---|---|---|---|
| Projekti | 2026 | 2027 | 2028 |
| Ndërtimi I shkollave | 700,000.00 | 600,000.00 | 600,000.00 |
| Meremetim I shkollave | 230,000.00 | 170,000.00 | 120,000.00 |
| Teknologji informative | 180,000.00 | 140,000.00 | 140,000.00 |
| Rregullimi I ngrohjeve qendrore | 70,000.00 | 40,000.00 | 40,000.00 |
| Fusha sportive | 90,000.00 | 60,000.00 | 60,000.00 |
| Objekte ndihmese | 30,000.00 | 30,000.00 | 30,000.00 |
| Rrethoja | 80,000.00 | 60,000.00 | 60,000.00 |
| Rregullimi I oborreve | 60,000.00 | 50,000.00 | 50,000.00 |
| Kabinete për shkolla | 140,000.00 | 70,000.00 | 70,000.00 |
| Inventar | 100,000.00 | 100,000.00 | 100,000.00 |
| | | | |
| | 1,680,000.00 | 1,320,000.00 | 1,270,000.00 |

### *1.4. Granti specifik për Shëndetësi primare*

Granti Specifik për shëndetësi primare sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e shëndetësisë primare të MSH për vitin 2026-2028.
Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2026 është aprovuar në shumë prej 87.52 milion euro, si
në vijim:
- Kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej 64.16 milion euro,
- Kategorija Mallra dhe shërbime 19.57 milion euro
- Shpenzime komunale 2.03 milion euro
- Koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.23 milion euro.
- Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë në shumë prej 2.13 milion euro (politik në vazhdimësi),
- Vizitat e kujdesit paliativ në shumë prej 2.1 milion euro (politik në vazhdimësi),
- Shpenzime tjera operative në mallra dhe shërbime në shumë prej 2.1 milion euro
- Shpenzime komunale në shumë prej 2.1 milion euro.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e shëndetësisë primare.
Komisioni i granteve, bazuar në kriteret e lartpërmendura Komunës së Vushtrrisë i është ndarë buxhet në vlerë prej 3,062,052.00€. Shuma e ndarë për shëndetësi për vitin 2026 është më e ulët për 526,645.00€. Qeveria komunale me komisionin e granteve është në angazhime për korrigjimin e kësaj zbritje.

Politika e re e aprovuara për vitin 2026 është:
V. Intervenimi në fëmijërinë e hershme në shumë prej 1.74 milion euro dhe staf shtesë prej 192, nga të cilët:
a. Logoped 48,
b. Psikolog 48,
c. Fizioterapeut 48, dhe
d. Punëtor social 48.

**Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2026**

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2026 do të jetë në shumë prej 3.5 milion euro.

Për Komunën e Vushtrrisë për financimin e shërbimeve rezidenciale janë të ndara 230,000.00 euro dhe ato në kategorinë:

| | |
|---|---|
| Paga dhe shtesa | 130.000.00€ |
| Mallra dhe shërbime | 75,000.00€ |
| Shpenzime komunale | 10,000.00€ |
| Shpenzime kapitale | 15,000.00€ |

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

**Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)**
Kërkesës së Komunave ju kanë përgjegjë Ministritë e linjës për hapjen e shtëpive të reja për personat e moshuar, për personat me aftësi të kufizuara dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve në shume prej 4.46 milion euro, do të financohet nga Granti i përgjithshëm, Për këtë qëllim komunës së Vushtrrisë ju kanë ndarë 230,000.00€

**Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2026 dhe parashikimet 2027- 2028**

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2026 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë aprovuar në shumë prej 115 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.
Në këto projeksione të të hyrave tatimore në pronë dhe tokë janë marrë parasysh parashikimet e pranuara nga departamenti i tatimit në pronë, ndërsa për projeksionet e të hyrave jo tatimore është marr për bazë mesatarja e realizimit të të hyrave jo tatimore në tri vitet e fundit, parashikimet nga komunat mbi trendin e rritjes së të hyrave jo tatimore dhe realizimin e të hyrave jo tatimore.

Tabela e planifikimi i të hyrave vetanake 2026 – 2028

| Komuna: Vushtri | THV - 2026 | THV - 2027 | THV - 2028 |
|---|---|---|---|
| **Buxhet dhe Financa** | **1,374,647.00** | **1,511,957.00** | **1,525,156.00** |
| **Taksat e firmave** | 20,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 |
| **Tatimi në pronë** | 1,070,296.00 | 1,147,892.00 | 1,159,371.00 |
| **Tatimi në toka** | 284,351.00 | 344,065.00 | 345,785.00 |
| **Ispektimet** | **18,000.00** | **19,000.00** | **19,500.00** |
| **Pranime teknike** | 12,000.00 | 12,500.00 | 12,500.00 |
| **Gjobat e inspekcionit** | 6,000.00 | 6,500.00 | 7,000.00 |
| **Administrata** | **40,000.00** | **40,000.00** | **40,000.00** |
| **Shërbimet administrative** | 40,000.00 | 40,000.00 | 40,000.00 |
| **Urbanizmi** | **885,000.00** | **896,550.00** | **935,923.00** |
| **Lejet për ndërtim dhe konstruktime** | 750,000.00 | 744,550.00 | 770,923.00 |
| **Leje mjedisore** | 100,000.00 | 110,000.00 | 115,000.00 |
| **Legalizim** | 10,000.00 | 12,000.00 | 15,000.00 |
| **Shfrytëzimi i pronës publike** | 25,000.00 | 30,000.00 | 35,000.00 |
| **Gjeodezi dhe kadastër** | **153,000.00** | **158,000.00** | **160,000.00** |
| **Hipoteka, RDDP, dalje në terren** | 100,000.00 | 100,000.00 | 100,000.00 |
| **Qiraja e pronave publike** | 53,000.00 | 58,000.00 | 60,000.00 |
| **Ekonomi dhe bujqësi** | **50,000.00** | **50,000.00** | **55,000.00** |
| **Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore** | 50,000.00 | 50,000.00 | 55,000.00 |

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kulturë, rini, sport** | **1,500.00** | **1,500.00** | **1,500.00** |
| **Palestra sportive** | 500.00 | 500.00 | 500.00 |
| **Bibliotekat** | 500.00 | 500.00 | 500.00 |
| **Shtëpia e kulturës** | 500.00 | 500.00 | 500.00 |
| **Shërbimet publike** | **1,068,000.00** | **1,167,500.00** | **1,113,127.00** |
| **Ndalja e veturave në rrugë** | 2,000.00 | 3,000.00 | 4,000.00 |
| **Taksat rrugore** | 180,000.00 | 182,000.00 | 183,000.00 |
| **Taksa për mbeturina** | 886,000.00 | 982,500.00 | 926,127.00 |
| Totali i Administratës komunale | **3,590,147.00** | **3,844,507.00** | **3,850,206.00** |
| **ARSIMI** | | | |
| Çerdhet | 120,000.00 | 125,000.00 | 130,000.00 |
| Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha" | 19,000.00 | 19,500.00 | 20,000.00 |
| Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi" | 30,000.00 | 31,000.00 | 32,000.00 |
| **Totali - Arsimi** | **169,000.00** | **175,500.00** | **182,000.00** |
| **TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA** | | | |
| Shëndetësia primare | 65,000.00 | 65,000.00 | 66,000.00 |
| Shërbimet sociale | 3,500.00 | 3,600.00 | 3,600.00 |
| TOTALI SHËNDETËSI | 68,500.00 | 68,600.00 | 69,600.00 |
| TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III) | 3,827,647.00 | 4,088,607.00 | 4,101,806.00 |

## VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2026-2028

Të hyrat e Komunës së Vushtrrisë nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare, si dhe të hyrat vetanake komunale.

| | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | Ndryshimi 2025/2027 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Granti i përgjithshëm | 11,343,396.00 | 12,210,626.00 | 13,152,267.00 | 14,208,519.00 | 867,230.00 | **7.10** |
| Granti i arsimit | 9,861,291.00 | 10,761,610.00 | 11,084,458.00 | 11,416,992.00 | 900,319.00 | **8.37** |
| Granti për shëndetësi | 2,732,608.00 | 3,062,052.00 | 3,153,914.00 | 3,248,531.00 | 329,444.00 | **10.76** |
| **Shërbimet Rezidenciale** | 200,000.00 | 230,000.00 | 200,000.00 | 200,000.00 | 30,000.00 | **13.04** |
| Gjithsejt grantet | 24,137,295.00 | 26,264,288.00 | 27,590,639.00 | 29,074,042.00 | 2,126,993.00 | **8.10** |
| të hyrat vetanake | 3,525,467.00 | 3,827,647.00 | 4,088,607.00 | 4,101,806.00 | 302,180.00 | **7.89** |
| Totali | 27,662,762.00 | 30,091,935.00 | 31,679,246.00 | 33,175,848.00 | 2,429,173.00 | **8.07** |

Buxheti total i komunës në vite, milion euro:

**KAB 2027-2028 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

Siç shihet në grafikon buxheti i ndarë për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2026 ka shënuar një rritje në shumë prej 2,429,173.00€,




| | Komuna Vushtrri | Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2025 | Grante dhe të hyra vetanake – 2026 | Grante dhe të hyra vetanake – 2027 | Grante dhe të hyra vetanake - 2028 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | në euro | në euro | në euro | në euro |
| | **Burimet e të hyrave** | | | | |
| | Granti i përgjithshëm | 11,343,396 | 12,210,626 | 13,152,267 | 14,208,519 |
| | Granti për arsim | 9,861,291 | 10,761,610 | 11,084,458 | 11,416,992 |
| | Granti për shëndetësi | 2,732,608 | 3,062,052 | 3,153,914 | 3,248,531 |
| | Shërbimet rezidenciale | 200,000 | 230,000 | 200,000 | 200,000 |
| | **Gjithsej grantet** | **24,137,295** | **26,264,288** | **27,590,639** | **29,074,042** |
